



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti
Ministria e Shëndetësisë
Ministartvo Zdravstva - Sağlık Bakanlığı
SHKUK - UBRSK - KOHKİ



SPITALI I PËRGJITHSHËM OPŠTA BOLNICA GENEL HASTANE
"Prim. Dr. Daut Mustafa"

Njësia Org.
Org. Jedarica
Org. Bolnica
Nr. i faqeve
Br. stranica
Sayfa no.

I
Nr. Prot.
Br. Prot.
Prot. No.
Data
Datum
Tarih
8/7
01.06.2022

P R I Z R E N



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova - Hospital and University Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital
"Prim. Dr. DAUT MUSTAFA" - Prizren

Në bazë të nenit 67, 68, 69 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik; Neni 13 dhe 22 të Statutit të Spitalit të Përgjithshëm Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren, si dhe kërkesës së aprovuar nga Bordi Drejtues i SHKUK për shpallje të Konkursit nr. 1474, të datës 25.05.2022., Këshilli Drejtues i Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren, në mbledhjen e mbajtur më 31.05.2022, mori vendim të shpall:

K O N K U R S

PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS NË KOHË TË PACAKTUAR

Institucioni : Spitali Përgjithshëm Prizren
Titulli i vendit të punës: Mjek-e specialist-e gjinekolog-e
Raporti: Shefit të repartit
Kontrata: Për kohë të pacaktuar
Koefficienti: 8.4
Orari i punës: 1 plotë (40 orë në javë)
Numri referencës: 8/7-06-2022

Qëllimi i pozitës: Ofrimi i shërbimeve shëndetësore të nivelit dytësor

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë:

- ✓ Kryen vizita të rregullta dhe punë brenda spitalore dhe ambulatore, sipas orarit të punës;
- ✓ Kryen konsultime dhe vizita në repartet tjera sipas nevojës;
- ✓ Kryen triazhin e pacientëve dhe sipas nevojës i udhëzon ata në mjekësinë familjare ose i pranon në spital;
- ✓ Kryen ekzaminimin mjekësor të pacientit, mbledh të dhëna për sëmundjen (diagnostifikim) dhe përcakton diagnozën;
- ✓ Përcakton dhe kryen trajtimin (terapinë) për sëmundjet e zbuluara, çrregullimet ose lëndimet;
- ✓ Dokumenton ekzaminimet e vazhdueshme mjekësore të pacientit, gjetjet, diagnozat dhe trajtimin e përshkruar, si dhe kujdeset për trajtimin e pacientëve;
- ✓ Monitoron dhe vlerëson efektet e trajtimit terapeutik;
- ✓ Bën punë kërkimore dhe ofron propozime të trajtimit sipas doktrinave profesionale;
- ✓ Merr pjesë në trajtimin e pacientëve me bazë ekipore - konziliare;
- ✓ Merr pjesë në edukimin e mjekëve dhe bashkëpunëtorëve të tjerë profesionalë në specializim ose përgjatë edukimit të vazhdueshëm profesional të tyre;
- ✓ Organizon intervenimin e shpejtë, vendosjen e terapi së urgjente të sëmurëve të rëndë;
- ✓ Regjistron të gjitha të dhënat në sistemin e informimit shëndetësor (SISh);
- ✓ Përgatit fletëdaljen (fletëlëshimin) për pacientët e hospitalizuar dhe raportin mjekësor për pacientët ambulatorë;
- ✓ Ushtron detyra plotësuese profesionale e menaxhuese, sipas nevojës dhe kërkesave të menaxhmentit;
- ✓ Respekton kodin e mirësjelljes, kujdesit dhe respektimit të pacientit dhe personelit;
- ✓ Ofron këshilla profesionale me shkrim e me gojë rreth trajtimit të pacientit dhe përcaktimit të terapi së ditore;
- ✓ Përcakton radhën dhe planin e ekzaminimeve kliniko-laboratorike;
- ✓ Bën kërkesa për vizita plotësuese-konsultative;
- ✓ Mbikqyr realizimin e detyrave ditore të punës së stafit;
- ✓ Jep mendime profesionale në punën e komisioneve të ndryshme;
- ✓ Monitoron punën dhe merr masa në rast të devijimit nga doktrina profesionale ose shkelja e kodit të deontologjisë mjekësore;
- ✓ Merr pjesë në përgatitjen e dokumentacionit dhe në ekzekutimin e aktiviteteve të prokurimit publik nga fusha e punës dhe përgjegjësi të tij;
- ✓ Në përfundimin e ditës së punës kalon informatat te stafi kujdestarë për ngjarjet dhe gjendjen e pacientëve;
- ✓ Bashkëpunon me shërbime të tjera profesionale në institucion;
- ✓ Angazhohet në punësimin e punonjësve të rinj mjekësorë në punë;
- ✓ Monitoron zhvillimin e profesionit me synim ruajtjen dhe përmirësimin e nivelit të ekspertizës dhe transferimin e informacionit në lidhje me ngjarjet në profesion;
- ✓ Përgatit materialet dhe mjetet e punës për përdorim dhe intervenim;
- ✓ Kujdeset dhe mirëmban pajisjet dhe mjetet e punës gjatë përdorimit;
- ✓ Mbron pronën e punës nga vjedhja, zhdukja, dëmtimi apo shkatërrimi;

- ✓ Ruan konfidencialitet të plotë për çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e pacientit apo punën e institucionit, përveç në rastet kur kjo autorizohet me shkrim, në përputhje me rregullat institucionale;
- ✓ Në rast të kërkesës për ekzaminime radiologjike, laboratorike, jep shpjegime mbi indikacionet;
- ✓ Kujdeset për ruajtjen e rendit në vendin e punës.

Detyrat specifike

- ✓ Kryen të gjitha punët profesionale specifike specialistike dhe subspecialistike;
- ✓ Merr pjesë në vizita konsultative dhe konziliare;
- ✓ Bën ultrazërin e organeve gjenitale;
- ✓ Bën amnioskopinë;
- ✓ Bën ndërhyrjen operative me laparoskop;
- ✓ Bën CTG-në dhe interpretimin e saj;
- ✓ Udhëheq procesin e lindjes në bazë të partografit;
- ✓ Kryen të gjitha ndërhyrjet operative gjinekologjike dhe obstetrike (HTV, HTA, SC, etj.);
- ✓ Bën trajtimin e të sëmurëve sipas protokoleve klinike në fuqi;
- ✓ Çdo herë pas kujdestarisë raporton te drejtori shëndetësor

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit:

- Arsimit universitar / diploma e fakultetit të mjekësisë)
- Licenca e specialistit-es të lëmisë përkatëse (licenca kopje)
- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë trajnime të veçanta , si dhe njohuri të maira të funksionimit të sistemit shëndetësor të Kosovës
- Të ketë shkathësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim
- Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme, ndërsa njohja e gjuhës angleze është përparësi
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerje të një vepre penale me dashje (Vërtetimi nga Gjykata kompetente)
- Letërnjoftimi (kopje)
- Certifikata e lindjes
- Mund të sillni edhe dëshmi tjera të aftësisimit profesional dhe akademik
- Të gjithë të punësuarit në SHSKUK, mjekë specialistë të kësaj fushe nuk kanë të drejtë aplikimi në këtë konkurs
- Originalin e këtyre dokumenteve ose të vërtetuara te noteri do të sillen vetëm atëherë kur kandidati thirret për nënshkrimin e kontratës.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës, mjekë specialist të lëmisë përkatëse, që nuk janë të punësuar në institucionet publike shëndetësore.

Procedurat e konkurrimit:

Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotësojnë kushtet e konkursit. Hapja e procedurës së konkurrimit shpallet në NJBNJ, në ueb faqen e konkurrimeve të SIMBNJ-së, të paktën 30 ditë para datës së planifikuar për paraqitjen e aplikimit nga kandidatët e interesuar, nga data 01.06.2022 deri më datën 30.06.2022, kurse dorëzimi i plikacioneve bëhet në afat prej 8 ditës, nga data 01.07.2022 deri më 08.07.2022.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën e personelit të Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren, Rruga "Sheh Emini", p.n.

Në aplikacion të ceket qartë vendi i punës dhe numri i referencës. Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkangjiten aplikacionit.

Aplikacionet e dërguara pas mbylljes së konkursit dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të ftohen në testim.

01.06.2022

Spitali i Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" Prizren
Prof. Asoc. Dr. Afrim Ayda
Drejtor ekzekutiv, u.d

